



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KULTURËS DHE SPORTIT
DREJTORIA E E KULTURËS

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____. _____. 2026

E nderuar

Në përgjigje të emailit tuaj për informacionet e kërkuara po ju informoj që Bashkia Shkodër ka nën varësi vetëm Bibliotekën Publike Marin Barleti, për të cilën po ju bashkëngjesim dhe detajet e kërkuara mbi buxhetin.

Librat dhe shërbimet e bibliotekave nuk janë të kufizuara vetëm tek një institucion i vetëm, por përfshijnë dhe bibliotekat universitare dhe disa të tjera të vogla, ndër të cilat mund t'ju përmendim:

- Biblioteka Universitare Shkodër (e Universitetit Luigj Gurakuqi Shkodër)
- Biblioteka e Qendres Rinore "Arka"
- Biblioteka e Seminarit Ndërdioqezian në Shkodër apo
- Biblioteka të disa shkollave (psh Biblioteka e shkollës së mesme "Oso Kuka").

Në lidhje me informacionin e kërkuar mbi librarit, brenda qytetit të Shkodrës ushtrojnë aktivitetin e tyre disa subjekte private në fushën e tregtimit të librit (librari), numri i të cilave varion sipas rregjistrimeve në QKB dhe liçensave përkatëse.

Buxheti për projektin e Bibliotekës Marin Barleti në Shkodër është emërtuar *Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës* e cila përfshin Blerje Periodik/gazeta, Blerje Librash dhe Blerje raftash, me vlerat si me poshte:

Biblioteka Publike Marin Barleti Shkodër						
Buxheti I akorduar (në lekë)	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
	720 000	1 100 000	1 000 000	1 200 000	1 200 000	1 200 000

Por në buxhetin e Bashkisë Shkodër nuk është vetëm ky fond I akorduar ndaj Bibliotekës sepse ka fonde të cilat janë në projekte të tjera ku përfshin psh Mirëmbajtjen e godinës, fonde për blerje materiale dhe pajisje për mirëfunksionimin e Bibliotekës si prsh materiale kancelarike, TIK, materiale pastrimit apo pajisje dhe materiale të tjera të nevojshme sipas dhe kërkesave të këtij objekti që mund të ketë çdo vit. Gjithashtu kemi dhe fonde në Buxhet mbi realizimin e aktiviteteve të Bibliotekës siç mund të jenë Honoraret për të ftuarit që marrin pjesë në këto aktivitete, shpenzimet e materialeve promovionale, si dhe fonde mbi akomodimin dhe trajtimin ushqimor për këto të ftuar.

Për më shume informacion të detajuar mund të eksploroni dhe faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër, ku janë të renditur të gjithë Buxhetet ndër vite, Projektbuxhetet Afatmesme apo dhe Raportimet e Monitorimit:

<https://bashkiashkoder.gov.al/buxheti/>

Duke ju falenderuar për interesimin tuaj,mbetemi në dispozicion për çdo sqarim të mëtejshëm.

KRYETAR

Benet BECI